



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 81 dt.30.04.1996

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.30.04.1996, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Kulturës “Mbi trajtimin me fonde të veprimtarive të Seksionit të Artit” për 6 mujorin e parë, në mbështetje të vendimit të K.M.Nr.309, dt.21.06.1993 si dhe të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

VENDOSI

1. Të miratohen fondet për 10(dhjetë) projekte kulturore të Seksionit të Artit të Drejtorisë Kulturore të Bashkisë për 6 mujorin e parë të vitit 1996.

Projekt Kulturor Nr.1

“Për shpërblimin e orkestrës frymore”, me shumën :
810.000 lekë.

Projekt Kulturor Nr.2

“Për Festivalin Kombëtar të Këngës Popullore (12-14 Mars) në Elbasan”, shumën prej : **200.000 lekë.**

Projekt Kulturor Nr.3

“Për turneun “Virtuozët e Rinj të Tiranës” në Hungari”,
shumën prej : **3.500 USD-amerikan.**

Projekt Kulturor Nr.4

“Për organizimin e Rinfest 96”, shumën prej : **105.000 lekë.**

Projekt Kulturor Nr.5

“Për organizimin e Festivalit të Këngës për fëmijë të qytetit Tiranës”, shumën prej : **210.000 lekë.**

Projekt Kulturor Nr.6

“Për organizimin e Festivalit Kombëtar, Ditët e Muzikës Shqiptare”, shumën prej : **700.000 lekë.**

Projekt Kulturor Nr.7

“Për realizimin e konkursit të këngës Ballkanike për fëmijë”, shumën prej : **3.250 USD-amerikan.**

Projekt Kulturor Nr.8

“Për realizimin e Spektaklit Sofra Tiranase”, në shumën prej : **400.000 lekë.**

Projekt Kulturor Nr.9

“Për realizimin e turneut të grupit artistik “Të rinjtë e Bashkisë së Tiranës” (shkolla e Baletit) jashtë shtetit”, shumën prej : **3.400 USD- amerikan.**

Projekt Kulturor Nr.10

“Për realizimin e javës së muzikës shqiptare”, jashtë shtetit, shumën prej : **2.000 USD-amerikan.**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Seksioni i Artit dhe Drejtoria e Financës së Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA